



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3302 / Prot
2

Rrëshen, më 05 . 08 . 2026

V E N D I M

Nr. 61 datë 29. 07. 2026

P Ë R

“DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM, PËR KALIMIN E OBJEKTIT NR. 1/107. ZONA KADASTRALE 3344, SIPËRFAQE PREJ 255 M² ME TRANSFERIM KAPITAL NË BASHKINË MIRDITË SI DHE MIRATIMIN E KËTIJ OBJEKTI PËR FUNKSION, “MUZE PËR INDUSTRIJË E BAKRIT NË RUBIK”, BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” *i ndryshuar*, ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e tyre në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” *i ndryshuar*, Shkresës të Shoqatës së Mineraleve të Dobishme Shqiptare me nr. 14/1 prot, datë 14.04.2026 të protokolluar në institucionin tonë me nr. 1679 prot, datë 15.04.2026, “Mbi ecurinë për ngritjen e Muzeut për Industrinë e Bakrit në Rubik”, *relacionin nr. 3302 datë 20.07.2026 dhe korrespondencat shkresore së bashku me projekt - vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), pas shqyrtimit e diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak;*

V E N D O S I

1. Të japë pëlqimin në parim për kalimin e objektit Nr. 1/107, Zonë Kadastrale 3244, sipërfaqe prej 255 m² me transferim kapital në Bashkinë Mirditë, si dhe miratimin e këtij objekti për funksion Muze për Industrinë e Bakrit në Rubik, Bashkia Mirditë
2. Kryetari i Bashkisë Mirditë të ndjekë procedurat administrative dhe ligjore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, e cila është pronare, dhe çdo institucioni tjetër kompetent, me qëllim realizimin e transferimit të pasurisë në favor të Bashkisë Mirditë
3. Relacioni nr.3302 datë 20.07.2026 dhe korrespondencat shkresore & Plan rilevimi për punime kadastrale, indeksi hartës_RU-C-3, bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

4. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve, Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Marrëdhënieve me Qytetarët).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë!

SEKRETAR


Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3302 / Prot
/1

Rrëshen më, 20 . 07 . 2026

P/VENDIM

Nr. 70 , datë 20 . 07 . 2026

PËR

**“DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM PËR KALIMIN E OBJEKTIT NR. 1/107, ZONË
KADASTRALE 3244, SIP. 255M² ME TRANSFERIM KAPITAL NË BASHKINË
MIRDITË SI DHE MIRATIMIN E KËTIJ OBJEKTI PËR FUNKSION MUZE PËR
INDUSTRINË E BAKRIT NË RUBIK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”; Ligjin Nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; Ligjin Nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM Nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e tyre në njësitë e qeverisjes vendore”; Shkresës të Shoqatës së Mineraleve të Dobishme Shqiptare me Nr. 14/1 Prot., datë 14.04.2026 të protokolluar në institucionin tonë me Nr. 1679 Prot., datë 15.04.2026 “Mbi ecurinë për ngritjen e Muzeut për Industrinë e Bakrit në Rubik”; projekt –vendimin dhe relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak:

V E N D O S I

1. Të japë pëlqimin në parim për kalimin e objektit Nr. 1/107, Zonë Kadastrale 3244. Sip. 255m² me transferim kapital në bashkinë Mirditë, si dhe miratimin e këtij objekti për funksion Muze për Industrinë e Bakrit në Rubik.
2. Kryetari i bashkisë Mirditë të ndjekë procedurat administrative dhe ligjore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, e cila është pronare, dhe çdo institucioni tjetër kompetent, me qëllim realizimin e transferimit të pasurisë në favor të bashkisë Mirditë.
3. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve, Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Marrëdhënieve me Qytetarët).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (të ndryshuar)!

SEKRETARI
Gaspar TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksandër PICA KU

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve

Dr. Juljan Vlashi



Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Dr. Ark. J. Tusha




Sektori Juridik

Juriste L. Gjergji



KRYETARI
Albert MËLYSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3302 Prot

Rrëshen më, 20. 07. 2026

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN PËR

**“DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM PËR KALIMIN E OBJEKTIT NR. 1/107, ZONË
KADASTRALE 3244, SIP. 255M² ME TRANSFERIM KAPITAL NË BASHKINË
MIRDITË SI DHE MIRATIMIN E KËTIJ OBJEKTI PËR FUNKSION MUZE PËR
INDUSTRI NË BAKRIT NË RUBIK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”; Ligjin Nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; Ligjin Nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM Nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e tyre në njësitë e qeverisjes vendore”; Shkresës të Shoqatës së Mineraleve të Dobishme Shqiptare me Nr. 14/1 Prot., datë 14.04.2026 të protokolluar në institucionin tonë me Nr. 1679 Prot., datë 15.04.2026 “Mbi ecurinë për ngritjen e Muzeut për Industrinë e Bakrit në Rubik”; projekt –vendimin dhe relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak:

TË NDERUAR KËSHILLTARË,

Në Bashkinë Mirditë është paraqitur një kërkesë nga specialistë dhe ish-punonjës të industrisë së bakrit, përfaqësuar nga Shoqata e Mineraleve të Dobishme Shqiptare, lidhur me ngritjen e një Muzeu të Industrisë së Bakrit në qytetin e Rubikut.

Nisma synon ruajtjen, promovimin dhe vlerësimin e trashëgimisë industriale të zonës, duke krijuar një hapësirë muzeale që do të dokumentojë historinë e industrisë së bakrit, kontributin e saj në zhvillimin ekonomik të vendit dhe do të shërbejë si një pikë referimi për edukimin, kulturën dhe zhvillimin e turizmit në Bashkinë Mirditë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, Ministria e Ekonomisë është shprehur se pushteti vendor ka një rol parësor në ndjekjen e procedurave ligjore dhe administrative për realizimin e projektit.

Për realizimin e këtij projekti është propozuar që muzeu të vendoset në godinën e ish-Zyrave të Uzinës së Bakrit Rubik, objekt me vlera historike dhe simbolike për industrinë minerare dhe

metalurgjike të vendit. Transferimi i kësaj pasurie në favor të Bashkisë Mirditë kërkon ndjekjen e procedurave ligjore pranë institucioneve kompetente.

Për këtë arsye, paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak projektvendimi për dhënien e pëlqimit në parim për fillimin e procedurave administrative dhe ligjore për transferimin e pasurisë në pronësi të Bashkisë Mirditë, me destinacion ndërtimin e Muzeut të Industrisë së Bakrit në Rubik. Pas miratimit të këtij vendimi, Bashkia Mirditë do t'i drejtohet ministrisë përkatëse me kërkesë zyrtare për transferimin e pasurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Miratimi i këtij projektvendimi përbën hapin e parë institucional për realizimin e një projekti me interes publik, i cili synon ruajtjen e trashëgimisë historike dhe industriale të Mirditës, promovimin e vlerave kulturore të zonës dhe zhvillimin e potencialit turistik e ekonomik të saj.


Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve

Dr. Juljan Vlashi



Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:

Dr. Ark. J. Tusha



KRYETARI

Albert MËLYSHI



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI_SHTET_

DATË 26.04.2026

QËLLIMI_PËR KALIM NË PRONËSI

VENDNDODHJA

BASHKIA_MIRDITË

DVASHK_LEZHË

ZONA KADASTRALE_3244

NUMRI PASURISË_1/107

INDEKSI HARTËS_RU - C - 3

TË DHËNAT E PASURISË

LLOJI PASURISË_TRUALL+ NDËRTESE

SIP.PASURISË= 255 m2

SIP.GJURMËS NDËRTIMIT 255 m2


NUMRI KATEVE_1

NUMRI PEMEVE_

X 482033.1593
Y 4626814.9201

KOORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 482127.8278
Y 4626814.9201



SHPJEGUES	
	Kufi parcele
	Kufi parcele për kalim në pronësi
	Objekt
	Objekt për kalim në pronësi

X 482033.1593
Y 4626752.1525

SH 1:500

X 482127.8278
Y 4626752.1525

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V					
2	L					
3	J					
4	P					

REALIZOI PËR BASHKINË MIRDITË

EMRI: _ INXH. MËHILL PAÇUKU

LICENCA: NR._T. 0043/4 DATË _24.07.2017

NËNSHKRIMI/VULA _

Mehill
Pacuku

Digitally signed by
Mehill Pacuku
Date: 2026.04.26
09:21:00 +0200

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _T, Z, O, G, D.

Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PËRCAKTIMI KUFIRIT: _T-Z-O-G-D-KP-KH;

Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

Plani i rievimit u hartua sipas kërkesës së palës kërkuese Bashkia Mirditë për kalim në pronësi të truallit dhe objektit me sipërfaqe baze 255 m2 [Truall+Objekt], bazuar në kartelën e pasurisë për pronën 1/107 zona kadastrale 3244. Aktualisht kjo pronë i është dhënë në Administrim shtetërisë "ALBBAKER" sha. Matjet u realizuan me instrument GNSS me datë 20/04/2026;

DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT
KY PLAN RILEVIMI ËSHTË HARTUAR BAZUAR KËRKESËS SË PALËS SË INTERESUAR PËR KALIMIN NË PRONËSI.

BASHKIA MIRDITË

KRYETARI

Z. ALBERT MËLYSHI

NËNSHKRIMI _

REALIZOI PËR ASHK

SPECIALISTI _

DVASHK LEZHË

NËNSHKRIMI _

KONFIRMOI

PËRGJEGJESI/DREJTORI _

NËNSHKRIMI / VULA _


Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

NR 1678 PDS
DI 15.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Shoqata e Mineraleve të Dobishme Shqiptare

Tiranë (tel : 0698186884



Nr. 14/1, prot.

Date 14/04/2026.

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë MIRDITE
Z. Albert MELYSHI

Rrëshen.

Lënda : Mbi ecurinë për ngritjen e Muzeut për Industrinë e Bakrit në Rubik.

I nderuar z. Melyshi,

Një grup specialistësh që kanë punuar dhe kontribuar në industrinë e bakrit në mbështetje të projekt – idenë zhvillimore mbi mundësinë e riaktivizimit të Uzinës së Rafinimit të Bakrit Rubik drejtuar Kryeministrit, Ministrisë të Ekonomisë, Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Mirditë, me shkresën nr 03/1 datë 03.02.2025, kemi paraqitur kërkesën për ngritjen e një muzeu industrial për industrinë e bakrit, në Rubik.

Ngritja e një muzeu të tillë në Rubik si qendra më e vjetër pasuese e Pirustëve, është një vlerë e shtuar, element kujtese në respekt të brezave paraardhës, duke shërbyer si njohje dhe për brezat e rinj për ecurinë e kësaj industrie, krahas promovimit të trashëgimisë kulturore e profesionale edhe për vizitorë nga vende të tjera të botës.

Një muze i tillë historik industrial në Rubik, sjell një model për krahinën e Mirditës por edhe në shkallë vendi, referuar edhe eksperiencave nga vende të zhvilluara në Europë etj, të cilat kanë investuar në trashëgiminë e tyre kulturore përfshirë edhe aspektet e kujtesës për zhvillimet industriale.

Në pergjigje të kësaj kerkese, Ministria e Ekonomisë me shkresën nr. 1611/1 datë 04.02.2025, ka shprehur dakortësinë në parim dhe mbështetjen profesionale sipas nevojave për ngritjen e një muzeu industrial në Rubik, duke cilësuar se për këtë procedurë pushteti vendor ka rolin parësor sipas kuadrit ligjor.

Për këtë ne si specialistë ndër variantet e mundëshme të sigurimit të një objekti ndërtimor të trashëguar kemi propozuar ish Zyrat e Uzinës Bakrit Rubik, pikërisht në vendin ku kanë qenë zyrat e ngritura nga italianët në vitet 40 të shekullit që investuan për hapjen e minjerës dhe ndertimin e metalurgjisë të bakrit.

Objekti aktualisht ka vite që nuk është në përdorim dhe është në pronësi të “Albakër” shoqëri në likuidim Tiranë (vartësi të Ministrisë Ekonomisë), e megjithëse ka dal në procedurë privatizimi, deri tani nuk ka patur interesim.

Sa më sipër, ne vlerësojmë se si fazë e parë duhet kerkuar objekti për të kaluar me transferim sipas ligjit tek pushteti vendor, e paralel të bëhet një takim me specialistë të kësaj industrie dhe stafin e bashkisë që merret me qendrat muzeale e kulturore dhe urbanistikës për një ide paraprake, në kuadrin e pershtatjes të ndertesës aktuale nepermjet jo vetem të rehabilitimit rrjedhojë e amortizimit por edhe mundësisë të zgjerimit dhe ngritjes të një kati në harmoni me mjedisin perreth.

Mbi këtë bazë, mendojmë se hapi kryesor që lidhet me angazhimin direkt të bashkisë Mirdite, është përgatitja e ecurisë më tej sipas fazave, duke paraqitur një projekt ide paraprake si në investimet e duhura për aspektin ndërtimor ashtu edhe fazat e tjera për menyren e pershtatjes të mjedisve dhe harmozimin e tyre me artefakte nga kjo industri, makete të improvizuara për paraqitjen sa më afer realitetit të kësaj industrie nga gjeologjia deri tek prodhimi i telave dhe kablllove, etj në konsulencë e bashkërendim me strukturat ligjore e të specializuara për muzetë siç rekomadon Ministria përgjegjëse për Kulturën në pergjigjen e saj.

Duke perfunduar shpresojmë se ky projekt me interes për Rubikun dhe Mirditën, do të vlerësohet nga Bashkia sepse është në harmoni të plotë dhe me politikat zhvillimore të vendit për turizmin ku bejnë pjesë edhe qendrat muzeale kulturore – industriale, duke filluar sa më shpejt praktikën për sigurimin e ndertesës e ne vijim me etapat e tjera.

Jemi të gatshëm për një takim të afert, nëse nevojitet prania e specialistëve të kesaj industrie për mendime në fazën aktuale të paraqitjes të ketij projekti për mirtatim në Keshillin e Bashkisë

Faleminderit për bashkëpunimin

KRYETARI I SHOQATES

Ing. Mark PREPKOLA



Jemi të bindur se angazhimi direkt i JUAJ z. Kryeministër, dhe Ministrave të linjes, aq më tepër për kërkesën e ngritjes të një MUZEU industrial, si profesionist që vjen nga fusha e Artit, krahas problemeve e projekteve të mëdha që qeveria ka në interes të vendit, do të mundësojë sigurimin e ndonjë investitori serioz e strategjik për riaktivizimin e Uzinës së Rafinimit të Bakrit në Rubik, dhe paralel mbështetjen për një objekt muzeal, me shumë interes për krahinën e Mirditës.

Me respekt

Nga Shoqata e "Mineraleve të dobishme shqiptare" dhe disa specialiste të gjeologjisë, minierave, pasurimit, metalurgjisë etj.

- 1- Inxh. Gjeolog: Mark Pepkola, Kryetar i shoqatës
- 2- Inxh. Metalurg: Nikollë Gega
- 3- Inxh. Kimist: Nikoll Marku
- 4- Inxh. Miniere: Dr. Martin Cukalla
- 5- Inxh. Gjeolog: Dr. Viktor Doda
- 6- Inxh. Gjeolog: Dr. Ded Kol Ndreu
- 7- Inxh. Gjeolog: Llesh Sulejmani
- 8- Inxh. Gjeolog: Dr. Gjon Kaza
- 9- Inxh. Gjeolog: Ferit Ukaj
- 10- Inxh. Gjeolog: Dr. Asllan Daci
- 11- Inxh. Miniere: Lame Stoja
- 12- Inxh. Pasurimi: Gjon Leti
- 13- Inxh. Pasurimi: Ndue Gjonaj
- 14- Inxh. Metalurg: Qerim Ismeni
- 15- Inxh. Metalurg: Prof. Dr. Nexhmedin Lohja
- 16- Inxh. Metalurg: Zef Lleshi
- 17- Inxh. Metalurg: Frederik Perdoçi
- 18- Inxh. Metalurg: Mark Leka
- 19- Inxh. Kimist: Ilir Peçi
- 20- Inxh. Kimist: Pashk Marku
- 21- Inxh. Gjeolog: Dr. Torin Deda
- 22- Inxh. Miniere: Ramiz Balla
- 23- Gazetari: Gjergj Marku
- 24- Inxh. Metalurg: Sali Cara

KRYETARI I SHOQATES

Ing. Mark PEPKOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVEDHE ZHVILLIMIT TË KULTURËS
DREJTORIA E POLITIKAVE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Nr. 1611/ prot.

Tiranë, më 17.2.2025

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr. 1611 prot, datë 04.02.2025.

Z. Mark PEPKOLA,

KRYETAR I SHOQATES SE MINERALEVE TE DOBISHME SHQIPTARE
Rruga "Muhamet Deliu", Fresku, Tiranë
Tel: 0698186884

Për dijeni:

KRYEMINISTRISË

BASHKISË MIRDITË

Në përgjigje tuajës nr.1611, datë 04.02.20245 (protokolli i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit) përmes të cilës keni paraqitur propozimin për hapjen e një muzeu industrial kushtuar historisë së industrisë së bakrit në Rubik, Mirditë, si një risi kulturore në funksion të promovimit të një prej sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare dhe ruajtjen e kujtesës për këtë fushë të industrive dhe shkencës, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) duke vlerësuar iniciativën tuaj për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë industriale e ushtron veprimtarinë e saj sipas rregullave dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, në zbatim të legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore, kryesisht të Ligjit 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", i ndryshuar.

Në këtë kuadër ajo ka në administrim muzetë kombëtarë, qendror si dhe pasuritë kulturore që gëzojnë statusin monument kulture, të cilat monitorohen, mbikëqyren nga institucionet e specializuara në varësi të MEKI.

Njëkohësisht në përmbushje të misionit të saj lidhur me ruajtjen mbrojtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe trashëgimisë historike, MEKI përmes ekspertëve të saj kontribuon edhe në përmirësimin e platformës muzeore të institucioneve në varësi të pushtetit vendor, apo edhe të iniciativave të tjera private, etj.

Në realizimin e këtij procesi ju informojmë se procedura për krijimin e një muzeu të ri bëhet në përputhje me Ligjin 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", specifikisht sipas parashikimeve të **nenit 214 dhe 215** të këtij ligji.

Duke vlerësuar nismën tuaj për përdorimin e trashëgimisë industriale dhe rivlerësimin e saj si potencial kulturor lokal e kombëtar ju rekomandojmë ndjekjen e procedurës për krijimin e muzeut vendor në përputhje me pikën 2 të nenit 214 të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

Referuar legjislacionit të lartpërmendur, **muzeu vendor** është institucion publik që krijohet, organizohet, riorganizohet dhe mbyllet me **Vendim të Këshillit Bashkiak**, me propozim të kryetarit të vetëqeverisjes vendore dhe miratim të Këshillit Kombëtar të Muzeve.

Për sa më sipër, kërkesa për krijimin e muzeut, shoqëruar me dokumentacionin përkatës paraqitet pranë Muzeut Historik Kombëtar, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Muzeve, **me qëllim marrjen e vendimit paraprak për krijimin e muzeut nga Këshilli Kombëtar i Muzeve.**

Dokumentacioni ndër të tjera duhet të provojë:

- (a) *ekzistencën e objekteve muzeore, koleksioneve, të shoqëruara me dokumentacionet përkatëse të lëshuara nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.*
- (b) *ekzistencën e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen, mbrojtjen e objekteve dhe zhvillimin e aktivitetit muzeor.*
- (c) *burime njerëzore dhe financiare, që sigurojnë qëndrueshmërinë e muzeu*
- (d) *(ç) strategjinë për zhvillimin e aktivitetit muzeor dhe muzeografinë.*

Kërkesë për krijimin e një muzeu mund të aplikohet në linkun e-Albania si më poshtë :

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14470

Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit mbetet e gatshme të asistojë brenda fushës së saj të përgjegjësisë nëpërmjet institucioneve të specializuara në varësi të saj për vlerësimin e dorëshkrimeve, dokumentave, koleksioneve me vlera artistike, letrare dhe historike dhe përmes ekspertëve të asistojë në ngritjen e linjës muzeore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Llambriola MISTO

